



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:083261

Datë: 17.12.2024

Numri i dokumentit: 06613514

PAKR.nr.458/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Krimeve të Rënda – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryetar i kolegjit, Vaton Durguti dhe Violeta Husaj Rugova - anëtar të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gresë Latifi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit K.F për shkak të veprës penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope, nga neni 273, par.2 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.91/2018 të datës 10.12.2018, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër të lëndës P.nr.140/2018 të datës 29.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, me datë 26.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.91/2018 e datës 10.12.2018, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër të lëndës P.nr.140/2018/ i datës 29.05.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin P.nr.140/2018 të datës 29.05.2024, të akuzuarin K.F, konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, e ka liruar nga aktakuza për kryerjen e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope, nga neni 273, par.2 të KPRK-së. Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk kishte.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit K.F av. V.B me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës të refuzoj ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë si të pabazuar.

Prokuroria e Apelit me parashtresën, PPA/I.nr.419/2024, datë 31.07.2024 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda të aprovohet ashtu që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim ndërsa përgjigja në ankesë e ushtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit K.F av.V.B të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPRK-së, në të cilën ka prezantuar i akuzuari K.F. ndërsa palët tjera edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt për ditën dhe kohën e mbajtjes së seancës, nuk kanë prezantuar në seancë, gjë që konstatohet nga fletë kthesa, si në shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit e Kosovës mbajti seancën e kolegjit gjyqësor dhe shqyrtoj shkresat e lëndës, gjithashtu vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se: **Ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet ankimore

Në ankesë Prokuroria Themelore në Mitrovicë pretendon se Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.10 pasi që në aktgjykim nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte ka marrë për bazë në rastin e vendosjes dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Gjykata në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse. Në rastin konkret Gjykata vetëm potencon se janë administruar provat mirëpo nuk paraqet arsye se pse i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara c që është detyrë e gjykatës siç është rasti me shënimin zyrtar të DHTN-së B.Sh. Gjykata ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike kur nxjerr përfundim se me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk mund të dëshmohet fajësia e të pandehurit K.F për veprën penale - Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPRK. Nga deklarata e të pandehurit M.Q, rezulton se është furnizuar me substancë narkotike nga i pandehuri K.F, numrin e të cilit e ka pasur të regjistruar në telefon si K.F, si dhe përmes numrit të telefonit 049/220262 po ashtu me të njëjtin ka komunikuar përmes fejbukut me emrin K.F prej të cilit në muajin Gusht të vitit 2018 dy (2) herë ka blerë substancë narkotike marihuanë në vlerë prej 5 euro. Se komunikimi mes M.Q dhe K.F ka ekzistuar rezulton nga shënimi zyrtar i hetuesit të DHTN-së B.Sh dt. 19.10.2018 nga i cili rezulton se K.F ka pasur në posedim numrin e telefonit 049/220262. se numri i telefonit 049/220262 në sistemin e të kaluarës kriminale të policisë së Kosovës e ka të evidentuar si numër i nënës së tij Xh.A. Gjithashtu i pandehuri M.Q. ka konfirmuar se ka komunikuar edhe përmes fejbukut i cili është hapur me emrin K.F, e në të cilën faqe është nxjerr edhe nga burimi i hapur i rrjetit social fejbuk. Sikur deklarimi i të pandehurit M.Q, të ishte i pasaktë atëherë shtrohet pyetja se prej nga erdhi informacioni se K.F ka poseduar numër të telefonit 049/220262, prej nga erdhi informacioni se fejbuku është hapur me K.F, të gjitha këto të shpjen te përfundimi se K.F i ka shitur substancë narkotike të pandehurit M.Q. Së këndejmi rezulton që Gjykata ka bërë shkeljen e Ligjit Penal kur të akuzuarin K.F, në bazë të nenit 363 par. 1 nënpar. 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës e liron nga akuza, meqenëse shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të paraqitura në më lartë janë ngushtë të lidhura me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe që padyshim drejtpërdrejtë ka ndikuar në aplikimin e gabuar të Ligjit Penal dhe si pasojë e kësaj është shkelur Ligji Penal. Mbi këto rrethana është propozuar si më lart.

Në përgjigje në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit K.Fav. V.B thekson se ankesa e Prokurorisë është tërësisht e pabazuar dhe pretendimet e ngritura në të njëjtën nuk qëndrojnë andaj ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore janë të pabazuara dhe nuk qëndrojnë shkeljet e pretenduara të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP-së për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, gjen se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, e në përputhshmëri të plotë me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsytet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar kështu, konform dispozitës të nenit 369 par.10 e lidhur me nenin 363 të KPPK-së, ku, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsytet për çdo pikë të aktgjykimit, si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë, meqenëse me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar nga PTH-në Mitrovicë.

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të paraqitura nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Gjykata e Apelit e Kosovës gjen se, gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari K.F ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope, nga neni 273, par.2 të KPRK-së, me ç ‘rast gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë duke marrë aktgjykimin e

ankimuar me të cilin të akuzuarin e ka liruar nga akuza pasi që nuk ka prova se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Kolegji penal i kësaj Gjykate, në këtë çështje penale vlerëson si të drejta përfundimet e shkallës së parë, e që deri tek kjo gjendje faktike gjykata e shkallës së parë ka ardhur pas administrimit të provave personale dhe materiale si: nga informacionet e policisë lidhur me të kaluarën kriminale të pandehurin K.F është konstatuar se i njëjti është akuzuar edhe për vepra tjera penale të kësaj natyre.

Nga shënimi zyrtar i datës 19.10.2018, i përpiluar nga hetuesi DHTN, regjioni i veriut, Mitrovicë, B.Sh, është konstatuar se i pandehuri K.F numrin 049-220-262 në sistemin e të kaluarës kriminale në PK e ka të evidentuar në emër të nënës së tij Xh.A.

I pandehuri K.F gjatë intervistimit në polici me datë 07.12.2018, ka deklaruar se ka qenë në kampin e romëve në Mitrovicë dy ose tri herë tek një shok i cili ka lojëra të fatit, i cili quhet P. dhe është 31 ose 32 vjeçar. I njëjti ka deklaruar se nuk e njoh personin me emrin M.Q dhe nuk ka dëgjuar kurrë për të. Po ashtu ka deklaruar se nuk përdor substanca narkotike.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me këto prova ka paraqitur konkludimet e veta, duke përshkruar në mënyrë të qartë dhe të drejtë se në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e vërtetojnë se i akuzuari K.F. e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet si në aktakuzë, për arsye se nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar se ai ka ndërmarr veprimet e përshkruara si në dispozitivin e aktakuzës.

Një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë si në aktgjykimin e ankimuar e mbështet edhe kolegji penal i kësaj gjykate si të drejtë dhe të ligjshëm ngase nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk rezulton të jetë provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari K.F. të ketë kryer veprën penale që i vihet në barrë, andaj qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, si në arsyetimin e saj, në fq.5 dhe 6 përkitazi me deklaratën e të pandehurit të dytë M.Q. të dhënë në polici me datën 28.06.2018 në referim të dispozitës së nenit 257 par.2 të KPP-së, e cila përcakton në mënyrë decidive se: *“Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një **deklaratë** ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaramit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit”*, si dhe qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, si në

arsyetimin e saj, në fq.6 në referim të dispozitës së nenit 119 par.5 të KPP-së ku parashihet se *“Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por ato nuk mund të shërbejnë si prova të vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit që i ka dhënë. Tutje ne këtë dispozitë ligjore parashihet se Deklaratat e të pandehurit të dhëna në çfarëdo konteksti me vullnet dhe pa shtrëngim, nuk mund të shërbejnë si provë ndaj të bashkëpandehurve në të njëjtën procedurë penale apo edhe në procedurën e veçuar, përveç kur ky Kod në mënyrë shpërthimore ka përcaktuar se deklarata e tillë mund të shërbej si provë”*, ky kolegji penal e gjen si të drejtë dhe të ligjshëm duke marrë për bazë faktin se Prokuroria nuk ka paraqitur asnjë provë tjetër e cila do të mund të shërbente si provë mbështetëse e deklaratës së dhënë nga i pandehuri M.Q., andaj duke qenë se në shqyrtim gjyqësor provat tjera nuk vërtetuan pretendimet e prokurorisë si në aktakuzë, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim të drejtë duke marr aktgjykim lirues konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, duke e liruar të akuzuarin nga akuza.

Përkitazi me pretendimin e shkeljes së ligjit penal, kolegji penal i kësaj gjykate të njëjtin e gjen si të pabazuar për faktin se duke qenë se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjendjen e fakteve e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, rezulton se në këtë rast nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë të prokurorisë, në këtë drejtim nuk ka as zbatim të ligjit penal e rrjedhimisht as shkelje të ligjit penal si pretendon prokuroria në ankesë, andaj, me përfundimin e gjykatës së shkallës së parë pajtohet edhe kjo Gjykatë si të drejtë dhe ligjor ndërsa pretendimet e prokurorisë si në ankesë i refuzoi si të pabazuara, pasi që si të tilla ishin të përgjithësuara, prandaj nga arsyet si më lartë kolegji i kësaj gjykate gjen se aktgjykimi i ankimuar është i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Krimeve të Rënda
PAKR.nr.458/2024, datë 26.11.2024

Bashkëpunëtore Profesionale,
Gresë Latifi

Kryetar i kolegjit,
Skender Çoçaj

Vaton Durguti

Violeta Husaj Rugova
